



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 3 gusht 2020
Nr. ref.: RK 1596/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI17/19

Parashtrues

**Zymer Neziri, Rexhep Doçi, Daut Bislimi, Xheladin Shala, Adem
Zejnullahu, Exhlale Dobruna, Mehmet Ahmetaj**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Udhëzimit Administrativ nr. 09/2015
për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues sipas
strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve-
stazhit pensional të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Zymer Neziri, Rexhep Doçi, Daut Bislimi, Xheladin Shala, Adem Zejnullahu, Exhlale Dobruna dhe Mehmet Ahmetaj të gjithë studiues në Institutin Albanologjik të Prishtinës (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës), të cilët i përfaqëson z. Riza Smaka.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë nenin 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 09/2015 për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve-stazhit pensional (në tekstin e mëtejme: Udhëzimi Administrativ), të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejme: MPMS).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Udhëzimit të lartcekur Administrativ të MPMS-së, i cili pretendohet të jetë në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 3 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 7 [Vlerat], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta). Parashtruesit e kërkesës po ashtu pretendojnë se Udhëzimi Administrativ i kontestuar është në kundërshtim me nenin 8 të Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti (në tekstin e mëtejme: Ligji për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113 (1) dhe (7) të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 të Rregullores së punës nr. 01/2018 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 30 janar 2019, parashtruesit dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata). Kërkesa ishte dorëzuar nga z. Riza Smaka, i cili kishte dorëzuar një autorizim për përfaqësim të parashtruesve të kërkesës. Autorizimi në fjalë ishte nënshkruar nga të gjithë parashtruesit e kërkesës, përveç z. Mehmet Ahmetaj.
6. Më 6 shkurt 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha anëtar.
7. Më 15 shkurt 2019, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesve për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi që të plotësohet formulari zyrtar i Gjykatës dhe të qartësohet se a është edhe ai vet njëri nga parashtruesit e kërkesës, apo vetëm përfaqësues i parashtruesve të kërkesës (ky fakt nuk ishte qartësuar në

kërkesë). Gjithashtu, Gjykata kërkoi edhe autorizimin për z. Mehmet Ahmetaj, ngase nënshkrimi i tij nuk figuronte në autorizimin e dorëzuar në Gjykatë.

8. Më 21 shkurt 2019, përfaqësuesi i parashtruesve dorëzoi formularin e kërkesës dhe disa dokumente tjera shtesë.
9. Më 26 shkurt 2019, njëri nga parashtruesit e kërkesës, respektivisht z. Mehmet Ahmetaj, deponoi nënshkrimin e tij në Gjykatë.
10. Më 18 mars 2019, Gjykata ri-përsëriti kërkesën për përfaqësuesin e parashtruesve, z. Riza Smaka, duke kërkuar edhe njëherë nga ai të qartësojë se a është edhe ai njëri nga parashtruesit e kërkesës apo vetëm përfaqësues i parashtruesve të kërkesës.
11. Më 21 mars 2019, z. Riza Smaka dorëzoi në Gjykatë përgjigjen e tij ku theksoi: *“Prof dr Riza Smaka jam i autorizuar për përfaqësim juridik”* të rastit KI17/19 dhe *“Nëse Gjykata do ta miratonte kërkesën lëndore, rasti do të shtrihej në favorin e të gjithë magjistrave dhe doktorëve të shkencave “Benefitium Cohesionis” pra edhe në favorin tim si i autorizuar për përfaqësim juridik të rastit.”*
12. Më 27 mars 2019, Gjykata njoftoi MPMS-në për regjistrimin e kërkesës dhe i ofroi mundësinë që të paraqes komente lidhur me rastin brenda një afati prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga momenti i pranimit të njoftimit. Brenda afatit të përcaktuar, Gjykata nuk pranoi ndonjë koment nga MPMS.
13. Më 9 korrik 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarin raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 5 qershor 2014, Ligji për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, u publikua në Gazetën Zyrtare dhe hyri në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas shpalljes.
15. Më 31 dhjetor 2015, MPMS-ja publikoi Udhëzimin e kontestuar Administrativ i cili kishte për qëllim *“të përcaktojë kushtet dhe kriteret për kategorizimin e pensionistëve kontributpagues, duke u bazuar në strukturën kualifikuese dhe kohëzgjatjen e pagesave të kontributeve pensionale,”* (Shih neni 1 i Udhëzimit Administrativ).
16. Ndërmjet datave 8 dhjetor 2016 dhe 2 nëntor 2018 parashtruesit e kërkesës kishin paraqitur disa kërkesa lidhur me çështjen e tyre, pranë: Sindikatës së Bashkuar të Arsimit Shkencës dhe Kulturës, Avokatit të Popullit, MPMS-së; Komisionit Parlamentar për Arsim, Shkencë, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacione dhe Ndërmarrësi; Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale. Në të gjitha këto kërkesa ata kishin paraqitur kërkesat dhe pretendimet e tyre në lidhje me atë se çfarë ata konsideronin se duhet tu takojë. Nga shumica e këtyre institucioneve kishin pranuar përgjigje me shkrim, ku në përgjigjen e kryetarit të Komisionit për Arsim ishte cekë se do të adresohen kërkesat e tyre dhe do kërkohet përgjigje nga ana e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Arsimit.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

17. Parashtruesit pretendojnë shkelje të paragrafit 2 të nenit 3 [Barazia para Ligjit] dhe 7 [Vlerat] të Kushtetutës.
18. Parashtruesit pretendojnë se dispozita e nenit 4 e Udhëzimit Administrativ nr. 09/2015 është *“në disfavorin e shfrytëzuesve të pensioneve të kontributpaguesve të moshës, me nivelin e masterit si dhe me gradën e doktorit të shkencës bashke me titujt përkatës, nuk është perfillur dispozita e nenit 8 të Ligjit nr. 04-L-131 për Skemat Pensionale, nga se, për dallim nga dhe për shfrytëzuesit e pensioneve të kontributpaguesve me arsimin fillor dhe të mesëm e të lartë, për shfrytëzuesit e pensioneve të kontributpaguesve me gradën master dhe me gradën e doktorit të shkencave, nuk është bërë kategorizimi kualifikues në ç’mënyrë, shfrytëzuesve të pensioneve të kontributpaguesve të moshës me nivelin Mr. dhe Dr. të shkencave, padrejtësisht ju është cenuar e drejta e garantuar me nenin 8 të Ligjit për Skemat Pensionale”*.
19. Më tej parashtruesit theksojnë se: *“sipas dispozitës së nenit 8 të Ligjit nr.04-L-131 për Skemat Pensionale, kategorizimi përkatësisht lartësia e pensionit kontributpagues të moshës konform me strukturën kualifikuese, me aktin nënligjor përkatës, do të duhej të elaborohej konkretisht për të gjitha shkallët e arsimit fillor, të mesëm, të lartë, superior, të nivelit magjistër dhe të gradës së doktorit të shkencës me titujt prof.ass.dr., prof. i asocuar dr., dhe prof. dr.!”*
20. Parashtruesit theksojnë që ka mangësi dispozita e nenit 8 të Ligjit 04-L-131 për Skemat Pensionale, si dhe Udhëzimi Administrativ nr.09-2015, për arsyeje se nuk është bërë kategorizimi adekuat i të njëjtëve sipas strukturës kualifikuese të lartësisë së pensioneve kontributpaguese të moshës.
21. Parashtruesit pretendojnë që: *“sipas nenit 8 të Ligjit për Skemat Pensionale, është dashtë që me nenin 4 të Udhëzimit Administrativ nr.09-2015, konform me shkallen e strukturës profesionale të caktohen koeficientet e pensionit kontributpagues edhe për shfrytëzuesit e pensioneve me gradat shkencore Mr. Sc dhe Dr. Sc, mirëpo nga harresa, neglizhenca apo tendenca eventuale, për shfrytëzuesit e pensionit kontributpagues me gradën shkencore Mr. Sc dhe Dr. Sc, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për dallim nga kategoritë tjera nuk ka caktuar asnjëfarë koeficienti”*.
22. Në fund, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që të nxjerrë Aktgjykim përmes së cilit:

“1. Të miratohet Kërkesa për interpretimin dhe vlerësimin e papërpunshmërisë së nenit 4 të UAKSHPKSK-it [Udhëzimit të kontestuar Administrativ] me nenin 8 të LPFSH-së [Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti],

2. Të nulohet dispozita e nenit 4 të UAKSHPKSK-së me konstatim se është në kundërshtim me nenin 8 të LPFSH-së,

3. Të obligohet Qeveria e Kosovës – Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale të amendojë nenin 4 të UAKSHPKSK-it duke stipuluar koeficiente

përkatës të strukturës kualifikuese edhe për shfrytëzuesit e pensionit kontributpagues të moshës me gradën shkencore Mr. Sci dhe Dr. Sci.

4. Të obligohet Qeveria e Kosovës – Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale që, konform me nenin 4 të amenduar të UAKSHPKSK-it, shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues të moshës me gradën shkencore Mr. Sci dhe Dr. Sci, nga dhjetori i vitit 2015 e tutje, të ju paguaje shumat mujore në para sipas koeficienteve të caktuar në përshtatje me strukturën kualifikuese.

5. Shumen e shpenzimeve në procedurë deri në realizimin e Kërkesës të obligohet për të paguar Qeveria e Kosovës – Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale.”

Dispozitat relevante ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

[...]

Neni 3.2

[Barazia para Ligjit]

2. Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.

Neni 7

[Vlerat]

1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.

2. Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.

LIGJI NR. 04/L-131 PËR SKEMAT PENSIONALE TË FINANCUARA NGA SHTETI

[...]

Neni 8

Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues të moshës

1. Të drejtën në pension kontributpagues të moshës e realizojnë të gjithë personat të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe të cilët:

1.1. kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare;

1.2. duhet të ketë stazh pensional kontributdhënës, sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999;

1.3. ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999.

2. Kategorizimi i shfrytëzuesve të pensionit kontributdhënës, sipas kohëzgjatjes së pagesës së kontributit sipas strukturës kualifikuese dhe kriterëve tjerë, përcaktohet me akt nënligjor, të cilin do ta miratojë ministria përkatëse.

3. Personat të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret për pension kontributpagues të moshës, nuk mund të jenë edhe shfrytëzues të ndonjë skeme tjetër pensionale të përcaktuar me këtë ligj.

4. Përjashtimisht, shfrytëzuesit e pensionit kontributpagues të moshës, dhe shfrytëzuesit e pensioneve tjerë të përcaktuara me këtë ligj, mund të jenë edhe shtetasit e huaj, me shtetin e të cilëve, Republika e Kosovës, lidh Marrëveshje Bilaterale për sigurimet sociale.

5. Dispozitat e Marrëveshjeve Bilaterale të sigurimeve sociale, të cilat i lidh Republika e Kosovës me shtetet përkatëse, kanë epërsi ndaj dispozitave të këtij ligji dhe ligjeve tjerë nga fusha e sigurimeve sociale.

6. Me këtë ligj u njihet stazhi i punës për pension kontributdhënës për vitet 1989-1999 punëtorëve të arsimit, të shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës.

Udhëzimi Administrativ (MPMS) nr.09/2015 për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve të stazhit pensional

[...]

Neni 4

Kategorizimi sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesave të kontributeve

1. Kategorizimi i shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues sipas strukturës kualifikuese, ndahet në katër (4) kategori:

1.1. Pensionistët me përgatitje shkollore të ultë;

1.2. Pensionistët me përgatitje shkollore të mesme;

1.3. Pensionistët me përgatitje shkollore të lartë;

1.4. Pensionistët me përgatitje shkollore superiore.

2. Kategorizimi i shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues sipas kohëzgjatjes së stazhit dhe pagesave të kontributeve, llogaritet sipas vlerës 0.5% për çdo vit, të shumës aktuale të pensionit kontributpagues.

3. Lartësia e shumës së pensioneve sipas paragrafit 1 të këtij neni, caktohet me vendim të Qeverisë pas konsultimit me Ministrinë e Financave.

4. Baza e pensionit kontributpagues është shuma e përcaktuar sipas vendimit të fundit të nxjerrë nga Qeveria e Kosovës nr.01/74 i datës 10.03.2014.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

23. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar;

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

25. Më tutje, Gjykata i referohet edhe neneve 47 dhe 49 të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 i Ligjit

[Kërkesa individuale]

1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Neni 49 i Ligjit

[Afatet]

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është

shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi.

26. Gjykata merr parasysh rregullin 39 (1) (a) të Rregullores së punës, që specifikon:

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

(a) Kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar”.

27. Fillimisht, Gjykata rikujton faktet e rastit dhe pretendimet kryesore të parashtruesve të kërkesës.

28. Ligji për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti kishte hyrë në fuqi në qershor të vitit 2014. Në dhjetor të vitit 2015, MPMS kishte nxjerrë Udhëzimin e kontestuar Administrativ. Para kësaj Gjykate, parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e Udhëzimit Administrativ të nxjerrë nga MPMS, më saktësisht nenin 4 të tij, duke pretenduar se i njejtë është në kundërshtim me nenet 3.2 dhe 7 të Kushtetutës, si dhe me nenin 8 të Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti. Si rrjedhojë, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që:

- (i) të interpretojë përputhshmërinë e nenin 4 të Udhëzimit të kontestuar Administrativ me nenin 8 të Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti;
- (ii) të anulohet neni 4 i Udhëzimit të kontestuar Administrativ duke konstatuar se i njejtë është në kundërshtim me nenin 8 të Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti;
- (iii) të obligojë MPMS-në që të amendamentojë nenin 4 të Udhëzimit të kontestuar Administrativ *“duke stipuluar koeficiente përkatës të strukturës kualifikuese edhe për shfrytëzuesit e pensionit kontributpagues të moshës me gradën shkencore Mr. Sci dhe Dr. Sci”*;
- (iv) të obligojë MPMS-në që konform amendamentimit të nenit 4 të Udhëzimit të kontestuar Administrativ *“shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues të moshës me gradën shkencore Mr. Sci dhe Dr. Sci, nga dhjetori i vitit 2015 e tutje, të ju paguaje shumat mujore në para sipas koeficienteve të caktuar në përshtatje me strukturën kualifikuese”*;
- (v) të obligojë MPMS-në që të paguaj shumën e shpenzimeve në procedurë deri në realizimin e Kërkesës së parashtruesve.

29. Në dritën e kësaj, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kishin paraqitur disa kërkesa lidhur me çështjen e tyre, pranë: Sindikatës së Bashkuar të Arsimit Shkencës dhe Kulturës, Avokatit të Popullit, MPMS-së, dhe dy Komisioneve Parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Por Gjykata vë në dukje se parashtruesit e kërkesës nuk kanë sqaruar epilogun e procedurave eventuale administrative në organet dhe trupat e cekur me lartë. Rrjedhimisht, ata nuk kontestojnë ndonjë vendim apo procedurë konkrete, administrative apo gjyqësore, sikundër që nuk dëshmojnë se si akti i kontestuar ka cenuar të drejtat dhe liritë e tyre individuale. Parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese vlerësimin e kushtetutshmërisë së Udhëzimit Administrativ të kontestuar.

30. Për sa i përket kërkesës së parashtruesve për vlerësim të kushtetutshmërisë së nenit 4 të Udhëzimit Administrativ, në raport me nenin 8 të Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, nën pretendimin se Udhëzimi Administrativ i MPMS është në kundërshtim me nenet 3.2 dhe 7 të Kushtetutës, Gjykata thekson qëndrimin e saj konsistent se personat fizikë ose juridikë nuk janë palë të autorizuar që të kërkojnë vlerësim abstrakt të përputhshmërisë së legjislacionit me Kushtetutën, apo kërkesa të natyrës *actio popularis*. Pra, në praktikë e saj gjyqësore, Gjykata në vazhdimësi ka theksuar se individët nuk mund të kontestojnë *in abstracto* akte normative të karakterit të përgjithshëm.
31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet posaçërisht vendimit të saj në rastin KI102/17, ku parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar që të vlerësohet kushtetutshmëria e po të njëjtit Udhëzim Administrativ të MPMS-së, që kontestohet edhe nga parashtruesit e tanishëm të kërkesës. Në atë rast, Gjykata kishte arsyetuar se parashtruesja e kërkesës “*në asnjë mënyrë nuk ka dëshmuar se si akti i kontestuar ka cenuar të drejtat dhe liritë e saj themelore*” dhe “*se teksti kushtetues dhe jurisprudenca e kësaj Gjykate nuk ua njohin të drejtën individëve që të kontestojnë in abstracto akte të karakterit të përgjithshëm.*” Për rrjedhojë, Gjykata e kishte deklaruar si të papranueshme kërkesën e parashtruesit për vlerësim të kushtetutshmërisë së të njëjtit Udhëzim Administrativ, duke konsideruar se kërkesa nuk ishte parashtruar nga një palë e autorizuar siç parashihet me nenin 113.7 të Kushtetutës (Shih, rasti e Gjykatës nr. KI102/17, parashtrues Meleq Ymeri, “*Vlerësim i kushtetutshmërisë së Udhëzimit Administrativ nr. 09/2015 për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve-stazhit pensional të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale*”, Aktvendim për papranueshmëri i 10 janarit 2018, paragrafët 19-22).
32. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata nuk sheh ndonjë rrethanë apo arsye të vendosë ndryshe nga praktika e saj e gjyqësore në raste të ngjashme.
33. Gjykata ripërsërit faktin se Kushtetuta nuk parasheh të drejtën e individëve që të paraqesin kërkesë për kontroll kushtetues abstrakt, gjegjësisht t’i sfidojnë drejtpërsëdrejti në Gjykatë Kushtetuese aktet e përgjithshme normative të autoriteteve publike. Kushtetuta ofron mbrojtje për individët sa i përket veprimeve ose mosveprimeve të autoriteteve publike, vetëm përbrenda fushëveprimit të përcaktuar me nenet 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës. Këto dispozita kushtetuese kërkojnë nga parashtruesit e kërkesave kushtetuese që të dëshmojnë se: (1) janë palë të autorizuar; (2) janë të prekur drejtpërsëdrejti nga akti konkret ose mosveprimi i autoriteteve publike; dhe (3) kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. (Shih, për këtë qëllim, mes autoriteteve tjera, rastet e Gjykatës: KI21/19, parashtrues *Pjetër Boçi*, Aktvendim për papranueshmëri i 27 majit 2019 – ku ishte kërkuar interpretim i legjislacionit relevant në lidhje me definimin e “pozitës zyrtare”, paragrafët 21-28 dhe referencat e cituara aty; KI92/12 parashtrues *Sali Hajdari*, Aktvendim për papranueshmëri i 6 dhjetorit 2012 – ku ishte kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit për Pensionet; KI62/12 parashtrues *Liridon Aliu*; Aktvendim për papranueshmëri i 20 shtatorit 2012 – ku ishte kërkuar interpretim i Kushtetutës; KI40/11 parashtrues *Zef Prenaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 23 shtatorit 2011 – ku ishte kërkuar vlerësim i

kushtetutshmërisë së Udhëzimit Administrativ nr. 11/2010 për pagesën e pensionit themelore të nxjerrë nga MPMS në tetor të vitit 2010).

34. Pra, sipas dispozitave relevante të Kushtetutës (neni 113.7) dhe të Ligjit (nenet 47 dhe 49), e vetmja mënyrë se si personat fizikë ose juridikë mund të kontestojnë kushtetutshmërinë e një ligji para Gjykatës Kushtetuese është nëse ata dëshmojnë se kërkesa e tyre nuk është e karakterit "*actio popularis*" – por që ata janë prekur nga një "ligj" në mënyrë direkte dhe të drejtpërdrejtë, në mungesë të ndonjë akti, vendimi ose mase që zbaton atë ligj. Në rrethanat e rastit konkret, siç u shpjegua më lartë, ky nuk ishte rasti.
35. Në dritë të kësaj që u tha më lart, Gjykata arrin në përfundimin se kërkesa duhet të shpallet e papranueshme sepse nuk është dorëzuar nga personat e autorizuar, siç përcaktohet me paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 të Kushtetutës, si dhe rregullin 39 (1) (a) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 9 korrik 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Bekim Sejdiu



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi